



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 10/2021
Datë: 26 janar 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Naime Krasniqi Jashanica, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/31/GJTHPR/2020-AD/GJTHPR/40/20, të datës 15 dhjetor 2021, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 26 janar 2021, në pajtim me nenin 14 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Naime Krasniqi Jashanica, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, **nuk është përgjegjës** për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe shkelje të pikave 4, 4.1, 4.2 pika 5 dhe 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.240/2020, të datës 26.10.2020, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/31/GJTHPR/2020/-AD/GJTHPR/40/20, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura për hetimin e bërë lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore të gjyqtarës së Gjykatës Themelore në Prishtinë Naime Krasniqi Jashanica. E njëjta dyshohet se në rastin e shqyrtimit gjyqësor për lëndën penale PKR.nr.16/2018, konkretisht seancën gjyqësore e cila ka qenë e planifikuar që të mbahet me datë 02.09.2020, është shtyrë nga kryetarja e trupit gjykues Krasniqi Jashanica me arsyetim se anëtarja e trupit gjykues është në pushim vjetor edhe pse e njëjta ka qenë në orar të punës.

Këtë njoftim për shtyrje të seancë gjyqësore në lëndën penale PKR.nr.16/2018, parashtuesja e ankesës gjyqtarja Kukaj Mekaj e kishte kuptuar nga Portali “Betimi për Drejtësi” me ç’rast ishte informuar se kishte dështuar të mbahet gjykimi.

Ky veprim i kryetares së trupit gjykues Naime Krasniqi Jashanica sipas parashtueses së ankesës është konsideruar shkelje disiplinore e përcaktuar nga neni 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe shkelje të pikave 4, 4.1, 4.2 pika 5 dhe 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 26 janar 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore në të cilën morën pjesë kryesuesja e panelit hetimor Teuta Krusha dhe subjekti i hetimit disiplinor Naime Krasniqi Jashanica.

Kryesuesja e panelit hetimor në fjalën hyrëse dhe përfundimtare deklaroi se qëndron pranë raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura dhe ka kërkuar nga KGJK-ja që të vendosë lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se a ka apo nuk ka shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarës Naime Krasniqi Jashanica me rastin e shtyrjes së seancës gjyqësore për lëndën penale PKR.nr.16/2018, e cila ka qenë e planifikuar që të mbahet me datë 02.09.2020. E njëjta kishte deklaruar para panelit hetimor se seanca gjyqësore e caktuar që të mbahet me 02.09.2020, është shtyrë për shkak të mungesës zyrtare ligjore dhe anëtares së trupit gjykues e cila siç ka deklaruar Kryetarja e trupit gjykues Krasniqi Jashanica ndodhet në pushim vjetor. Për këtë shtyrje të seancës gjyqësore gjyqtarja Krasniqi Jashanica në cilësinë e kryetares së trupit gjykues kishte mbajtur një shënim zyrtar, që ndodhet në shkresat e lëndës.

Gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica në fjalën hyrëse dhe përfundimtare deklaroi se qëndron në tërësi pranë deklaratave të dhëna para panelit hetimor. Deklaroi se ajo në një periudhë rreth 6 muajve nuk ka pasur zyrtare ligjore dhe e ka pasur gati të pamundur të mbajë seanca gjyqësore. Ka theksuar se ajo përkundër kërkesave drejtuar kryetares së gjykatës, drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nuk ju ka siguruar një zyrtare ligjore për mbajtje të procesverbalit.

Me tutje ka deklaruar se arsyeja se pse ajo e kishte shtyrë seancën dëgjimore të datë 02.09.2020 për lëndën penale PKR.nr.16/2018, ka qenë mungesa e zyrtare ligjore, palëve tjera në procedurë dhe e anëtares e trupit gjykues . Ka theksuar se gjyqtarja ka qenë e njoftuar për orën dhe datën e seancës gjyqësore të datës 02.09.2020. Në ditën kur ka qenë e caktuar mbajtja e seancës gjyqësore në cilësinë e kryetares së trupit gjykues e kishte thirrur në telefon disa herë anëtarin e trupit gjykues dhe pasi që gjyqtarja nuk ishte lajmëruar në telefon, dhe se me të njëjtën gjyqtare disa ditë më herët kishte biseduar dhe i kishte thënë se po planifikon të shkojë në pushime, dhe e gjendur në një situatë të tillë gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica si kryetare e trupit gjykues me rastin e shtyrjes së seancës konkrete për lëndën penale PKR.nr.16/2018, kishte deklaruar që përveç mungesës së palëve tjera edhe anëtarja e trupit gjykues nuk është prezentë sepse është në pushim vjetor.

Për të vërtetuar këtë gjendje faktike, Këshilli Gjyqësor i Kosovës administroj provat materiale siç janë: Raporti mbi provat dhe faktet e mbledhura gjatë procedurës hetimore i datës të datës 15 dhjetor 2021, shënimin zyrtar të gjyqtarës Naime Krasniqi Jashanica që e kishte përpiluar me rastin e shtyrjes së seancës gjyqësore të caktuar që të mbahet me datë 02.09.2020, raportin ligjor nga PTK Vala me hyrje dalje të thirrjeve telefonike të bëra nga gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica me datë 02.09.2020 për thirrjet e bëra lidhur me rastin konkret, njoftimin e parashtresës së ankesës disiplinore gjyqtarës drejtuar Kryetares së gjykatës, si dhe të gjitha provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjyqtarja në deklaratën e saj të drejtuar kryetares së Gjykatës, e kishte shprehur shqetësimin e saj lidhur me shkrimin e lexuar në portalin “Betimi per Drejtesi” ku ishte dhënë informacioni se kishte dështuar të mbahet gjykimi për keqpërdorim të detyrës zyrtare ndaj zyrtareve të Ministrisë së Infrastrukturës. Sipas këtij portali kryetarja e trupit gjykues Naime Krasniqi Jashanica e kishte shtyrë seancën me arsyetim se kishte munguar anëtarja e trupit gjykues Pas këtij shqetësimi gjyqtarja kishte komunikuar me kryetaren e trupit gjykues Krasniqi Jashanica dhe e njëjta i kishte thënë se e ka thirrur disa herë në telefon mirëpo ajo nuk ishte lajmëruar.

Pas vlerësimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK-ja vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica në cilësinë e kryetares së trupit gjykues me rasti e shtyrjes së seancë gjyqësore në lëndën penale PKR.nr.16/2018, ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe shkelje të pikave 4, 4.1, 4.2 pika 5 dhe 5.2 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Para Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjyqtarja Krasniqi Jashanica në cilësinë e kryetares së trupit gjykues deklaroj se anëtarja e trupit gjykues [ca qenë e njoftuar për seancën gjyqësore të datës 02.09.2020, dhe, kur ishte dashtë të mbahet shqyrtimi eivësor me datë 02.09.2020, e kishte thirrur në telefon disa herë anëtarin e trupit gjykues dhe pasi që ajo nuk ishte përgjigjur në telefon dhe se me të njëjtën disa ditë me herët ka biseduar dhe i kishte treguar se po planifikon të shkoj në pushim vjetor, ka pretenduar se e njëjta ndodhet në pushim vjetor.

Me tutje, KGJK-ja ka vlerësuar se në bazë të provave të shkresave të lëndës dhe deklaratës së gjyqtares Krasniqi Jashanica është konstatuar se arsyeja e shtyrjes së seancë gjyqësore për lëndën penale PKR.nr.16/2018, të datës 02.09.2020, nuk ka qenë vetëm mungesa e anëtares së trupit gjykues por arsyeje për këtë shtyrje të seancës gjyqësore ka qenë komunikimi jo i duhur në mes të kryetares së trupit gjykues dhe anëtares lidhur me shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 02.09.2020 dhe mungesa edhe e palëve tjera, gjë që e ka bërë të pamundur mbajtjes e seancës gjyqësore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerëson se aplikimi i gabuar dhe jo o drejtë i të drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës së tyre mund të shërbej si kriter në vlerësimin e performancës së gjyqtarit të caktuar. Në seancën për këshillim dhe votim KGJK-ja konstaton dhe njëzëri vendosi se kryetarja e trupit gjykues Naime Krasniqi Jashanica në këtë rast konkret nuk është përgjegjëse për shkelje disiplinore të pretenduara nga Autoriteti Kompetent.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.10/2021, datë: 26 janar 2021

Skender COCAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Arben Hoti, u.d Kryetar, Gjykata Themelore në Prishtinë;
- Naime Krasniqi Jashanica,, Gjyqtare, Gjykata Themelore në Prishtinë;
- Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;
- Arkivit.